



UNMIK/REG/2005/17  
9 prill 2005

---

**RREGULLORE NR.2005/17**

**PËR SHPALLJEN E  
LIGJIT MBI ADMINISTRATËN DHE PROCEDURAT TATIMORE  
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 8 dhe me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin mbi administratën dhe procedurat tatimore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2004,

Duke vënë re se dispozitat e këtij Ligji nuk cenojnë autorizimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo pushtetin dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese, duke përfshirë nenin 8.1 (c) dhe nenin 8.1 (x) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke filluar nga data e nënshkrimit të Ligjit mbi administratën dhe procedurat tatimore (Ligji nr. 2004/48) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës të bashkëngjitur në këtë Rregullore, shpall si në vijim, me kusht që:

- (a) Në nenin 1:
  - (i) Në përkufizimin e “punëdhënësit”, fjalët “përpos atyre që janë të liruar nga tatimet sipas ligjit në fuqi” të shtohen në fund të nënparagrafit (e);

(ii) Në përkufizimin e “subjektit”, fjalët “publike dhe” të shtohen para fjalës “shoqërore” dhe

(iii) Në përkufizimin e “deklaratës tatimore” të shtohet nënparagrafi i ri (g) si në vijim: “deklarata për tatimin në të ardhurat e korporatave”;

(b) Neni 2.1 të ndryshohet si në vijim:

Administrata tatimore në Kosovë (më tutje në tekst “ATK”), ashtu siç është themeluar, ka statusin e agjencisë ekzekutive dhe funksionon me mëvetesi të plotë operacionale në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave;

(c) Të shtohet neni i ri 2.3 si në vijim:

Në përmbushjen e përgjegjësisë së saj sipas nenit 2.2 është detyrë e ATK-së të vjelë sa më shumë të ardhura që zbatohen sipas ligjit, duke marrë parasysh:

- a. Burimet në dispozicion të ATK-së;
- b. Rëndësinë e avancimit të respektimit, posaçërisht respektimit të vullnetshëm të legjislaturës tatimore të Kosovës nga të gjithë tatimpaguesit;
- c. Shpenzimet e respektimit të legjislaturës të bëra nga tatimpaguesit;

(d) Neni 3.1 të ndryshohet si në vijim:

ATK-ja udhëhiqet nga drejtori, i cili emërohet nga PSSP-ja, bazuar në rekomandimin e bërë përmes Qeverisë nga ministri i Ekonomisë dhe i Financave;

(e) Neni 3.2 ndryshohet si në vijim:

PSSP-ja në konsultim me Qeverinë mund ta shkarkojë drejtorin vetëm për shkak të paaftësisë profesionale apo të sjelljes së keqe ose pasi të jetë shpallur fajtor për shkelje penale dhe të jetë dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh apo më shumë;

(f) Në nenin 11.5, fjalët “Zyra e UNMIK-ut për ndërlidhje të organizatave joqeveritare” të shlyhen dhe të zëvendësohen me fjalën “UNMIK”;

(g) Në nenin 13.1, fjalët “pa paralajmërim” të zëvendësohen me fjalët “me paralajmërim, përveç nëse sipas mendimit të drejtorit rrethanat e jashtëzakonshme e

arsyetojnë ndryshe”, dhe fjalët “cilatdo objekte, vend” të zëvendësohen me “cilatdo objekte ku kryhen punët afariste”;

(h) Në nenin 13.3, nënparagrafët (b) dhe (e) fjala “konfiskon” të zëvendësohet me “kërkon bartjen e posedimit të”;

(i) Të shtohet neni i ri 13.6 si në vijim:

Në kohën e marrjes në posedim të dokumentit ose të sendit sipas nënparagrafëve (b) dhe (e) të këtij neni ATK-ja, me kërkesë të tatimpaguesit në fjalë, lëshon një vërtetim ku ceket dokumenti apo sendi, data kur dokumenti apo sendi është marrë në posedim dhe zyrtari i ATK-së të cilit i është dorëzuar;

(j) Në nenin 21.6, fjalët “i licencuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK)” të shtohen pas fjalës “bankë” dhe para fjalës “autorizuar”;

(k) Në nenin 34.1, fjalët “në përputhje me memorandumun e mirëkuptimit mes ATK-së dhe Shërbimit Doganor të UNMIK-ut” të shtohen në fund të fjalisë;

(l) Neni 46.2 të ndryshohet si në vijim:

Çdo person nga i cili kërkohet të krijojë apo të mbajë regjistrime sipas ligjeve në fuqi në Kosovë dhe i cili nuk e bën këtë është përgjegjës për pagesën e gjobës prej 125 eurosh. Për më tepër, personi është përgjegjës për pagesën e dënimit në shumë prej:

- a. Njëzet e pesë për qind (25%) të tatimit të vlerësuar për regjistrimet përkatëse, nëse moskryerja e regjistrimit është pasojë e moskujdesit të madh nga ana e personit dhe
- b. Njëqind për qind (100%) të tatimit të vlerësuar për regjistrimet përkatëse, nëse moskryerja e regjistrimit është pasojë e tentimit të qëllimshëm për t’iu shmangur pagesës së tatimit;

(m) Neni 51.3 të shlyhet:

(n) Neni 52 deri në nenin 55 dhe, rrjedhimisht, fjalët “apo i cili kryen shkelje sipas neneve 52 deri në 55,”, ”ose që ka kryer shkelje të tillë” dhe “apo shkelja” në nenin 51 të shlyhen dhe neneve vijuese t’u vihen numrat e ri;

(o) Neni 57.2 të ndryshohet si në vijim:

Anëtarët e Bordit propozohen nga Qeveria bazuar vetëm në aftësinë për kryerjen e funksioneve të tyre. Anëtarët emërohen nga Kuvendi, përpos dy (2) anëtarëve të Bordit, të cilët emërohen nga PSSP-ja pas konsultimeve

me Qeverinë. Në emërimin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, emërohen shtatë (7) anëtarë me mandat njëvjeçar (1) dhe tetë (8) anëtarë emërohen me mandat dyvjeçar (2), i cili mund të ripërtëritet edhe për një mandat dyvjeçar (2). Prandaj, secili anëtar do të ketë mandat dyvjeçar (2). Emërimet sipas këtij neni fillojnë më 1 qershor 2005.

(p) Neni 57.5 të ndryshohet si në vijim:

Kuvendi mund të shkarkojë një apo më shumë anëtarë të Bordit pas sugjerimit të Qeverisë, nëse konstaton se anëtari nuk është në gjendje t'i kryejë funksionet e tij ose është në pozitë të konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 59.5, me përjashtim që çdo anëtar i emëruar nga PSSP-ja të mund të shkarkohet vetëm nga PSSP-ja për arsye të njëjta dhe pas konsultimeve me Qeverinë. Kuvendi apo PSSP-ja, sipas rastit, emërojnë anëtarin e ri për të zëvendësuar anëtarin i cili është shkarkuar sipas këtij neni apo ka dhënë dorëheqje nga anëtarësia në Bord ose është i paafte t'i kryejë funksionet e tij. Anëtari i emëruar në mënyrë të tillë shërben gjatë pjesës së mbetur të mandatit të anëtarit të zëvendësuar dhe emërimi i tillë konsiderohet si emërim i parë;

(q) Në nenin 59.1, fjalët “me kërkesë të Bordit” të shtohen pas fjalës “mund” dhe para fjalës “themeloj”;

(r) Neni 59.6 të ndryshohet si në vijim:

Anëtarët e Bordit i mbajnë konfidenciale të gjitha informatat dhe të dhënat e marra për tatimpaguesin. Ky obligim vazhdon edhe pasi të ketë përfunduar mandati i tyre;

(s) Neni 65 të ndryshohet si në vijim:

Ky Ligj zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 mbi administratën dhe procedurat tatimore dhe shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk përputhet me të;

(t) Neni 66 “Ligji i shfuqizuar” të shlyhet dhe neneve vijuese t'u vihen numra të tjerë;

(u) Referimet në fjalën “dënime” të shlyhen dhe të zëvendësohen me fjalën “sanksione” kudo që shfaqen në tekstin e Ligjit, përpos referimit në nenin 15.4 dhe

(v) Neni 67 ndryshohet si në vijim:

Ky Ligj hyn në fuqi më 1 maj 2005.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar më 9 prill 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm